



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 965 /

Tirane, date 22.1.2015

Drejtuar: **Z. PRENG DEDA**
SHOQERIA "VLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT" SH.P.K
FSHATI SHKOZE' KOMUNA GJEGJAN

PUKE

Për njoftim: **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1618 date 02.04.2013.

I nderuar z. Deda,

Shoqëria "Vlaznimi Deda Import - Eksport" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1618 date 02.04.2013, në objektin "Shkalla e Gjadrit", për mineral kromi, Ungrej, ne Qarkun Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.2053 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.965 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes nr.1618 date 02.04.2013, në objektin "Shkalla e Gjadrit", për mineral kromi, Ungrej, ne Qarkun Lezhë, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2014-2015.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germen "ç" te pikës 1, te nenit 47(neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.1618 date 02.04.2013, në objektin "Shkalla e Gjadrit", për mineral kromi, Ungrej, ne Qarkun Lezhë, qe shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1618 date 02.04.2013.

Ne zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

